

AKT THEMELIMI

i shoqërisë "Puri San" Sh.p.k

Sot, më datë 17/ 03/ 2021,

Znj. Frida Pashako, shtetase shqiptare, atësia Kujtim, lindur më 23.08.1983 në Tiranë, e banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 034374490 dhe nr. Personal I35823066U, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Puri San" sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria")

Neni 1 Emërtimi

Emri i shoqërisë është "Puri San" Sh.p.k.

Neni 2 Selia

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Hoxha Tahsin", Nr.24, Tiranë. Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4 Objekti

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë ofrimin e shërbimeve ndërhyrëse higjeno-shëndetësore (dezinfektim, deratizim, dezinfektim, DDD); Shërbime pastrimi, higjenizimi, deodorizimi dhe ekspertizë higjeno-sanitare për ambiente të ndryshme; Import-export, prodhim/shitje me shumicë dhe pakicë të produkteve/pajisjeve higjeno-sanitare, produkte ekologjike, industriale, komerciale, materiale mirëmbajtje, si dhe çdo operacion tregëtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi; Përfaqësimi i shoqërive të huaja; Shitja e produkteve mbrojtëse personale dhe te DDD-ve; Shitja e sistemeve të filtrimit dhe higjenizimit të ujit; Shërbime DDD për mjetet tokësore, detare dhe ajrore;

Neni 5 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakut themelues në vlerën 100,000.00 (njëqind mijë) Lekë. Kapitali themeltar përbëhet nga 100 (njëqind) kuota me vlerë



nominale 1,000.00 (një mijë) Lekë, e cila është paguar dhe zotërohet tërësisht nga ortakët i vetëm themelues.

Neni 6
Organet e Shoqërisë

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi Administrativ;

1. Asambleja e Ortakëve është organi vendimmarrës e shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
2. Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, znj. Klaudia Cenomeri, shtetase shqiptar, lindur më 22.02.1990, i cili zgjidhet për një afat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.

Neni 7
Legjislacioni i aplikueshëm

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si edhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8
Dispozita Finale

Ky akt themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar Administratorin znj. Klaudia Cenomeri, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

Ortaku Themelues

Frida Pashako

Frida Pashako

